



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS


NOTER FJOREL R. ÇOMO
ADRESA KONGRESI I ELBASANIT,
28 NENTORI, NR. 33
TEL: 692279111

VENDIM PËR LËSHIMIN E DËSHMISE SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Nr. repertori: 142

Nr. koleksioni: 106

Elbasan më 22/02/2022



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2022010480010852552





A2022010480010852552

Taksa e Pullës u Pagua

**LËSHIMI I DËSHMISË
SË TRASHËGIMISË LIGJORE**

Sot, më datë 22.02.2022, para meje Noter FJOREL R. ÇOMO, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Elbasan, KONGRESI I ELBASANIT, 28 NENTORI, NR. 33, u paraqit personalisht:

KËRKUESJA:

znj. LAVDIJE JANÇA, atësia Halit, amësia Sose, shtetase Shqiptare, lindur në Shushicë dhe banuese në Elbasan, me adresë Lagja Qemal Stafa Rruga Çerçiz Topulli; Nd. 10; H. H.15; Ap. Ap.16; Elbasan; Elbasan; 3002; Elbasan, lindur më 16/03/1970, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034055281 dhe nr. personal H05316013W.

OBJEKTI:

Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerin **HALIT JAKUP PETALLI**

BAZA LIGJORE: Nenet 316, 317, 318, 348, 360, 361 e vijues i ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë", me ndryshimet, neni 61, pika 1, shkronja d, j; nenet 97, 111, 112, 113 e vijues të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

Pasi administrova në tërësi provat shkresore të prezantuara nga kërkuesi dhe dëgjova pretendimet e tij, Unë Noteri kryesisht, bazuar në nenin 111, 113 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të kërkesës, verifikova dhe konstatova se kjo çështje hyn në kompetencën e Shërbimit Noterial, të Degës Vendore Durrës, përkatësisht Noter FJOREL R. ÇOMO, me zyrë Noterie në Elbasan, KONGRESI I ELBASANIT, 28 NENTORI, NR. 33, territor mbi të cilën shtrin kompetencën kjo zyrë për shqyrtimin e kësaj kërkesë. Në këto kushte,

VËREJ SE:

Kërkuesja Lavdije Janca, është e bija e trashëgimlënësit Halit Jakup Petalli ndaj në bazë të nenit 32 të K.Pr.C, ka interes të ligjshëm për të kërkuar lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë.

Nëpërmjet kësaj kërkesë kërkohet lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore të trashëgimlënësit **Halit Jakup Petalli**, i cili rezulton të ketë qenë banues në Gostimë, Elbasan dhe bazuar në nenin 318/1 të Kodit Civil, të ndryshuar, Trashëgimia çelet në vendin ku ka pasur vendbanimin e fundit trashëgimlënësi, pra Zyra Noteriale Elbasan ka kompetencën për lëshimin e kësaj dëshmie.

Nga çertifikata e vdekjes rezulton se trashëgimlënësi **Halit Petalli**, ka vdekur më datë **14.10.1998** në **Gostimë, Elbasan** me gjendje civile i martuar.

Me vdekjen e tij çelet trashëgimia, e cila sipas përcaktimeve të nenit 318 të Kodit Civil, do të rregullohet me dispozitat për trashëgiminë e ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e çeljes së trashëgimit, pra do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil në fuqi.

Duke qenë se sipas informacionit të marrë zyrtarisht prej meje nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, **nuk rezulton që trashëgimlënësi të ketë disponuar me testament** pasurinë e tij për kohën pas vdekjes, do të zbatohet trashëgimia ligjore, duke lëshuar dëshminë e trashëgimisë për trashëgimlënësin **Halit Petalli**.

Nga shqyrtimi i çertifikatave të gjendjes familjare, personale, si dhe çertifikat e martesës, rezulton se :

Në bazë të çertifikatës së Martesës nga Akti me nr. 66 dt. 15.11.1954 të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Arkiva Rrethi Elbasan, me dt. lëshimi 09.02.2022 vërtetohet se z. Halit Jakup Petalli dhe z.nj Sose Zyfer Petalli (Dalipi) kanë lidhur martesë mes tyre. Sipas kësaj Çertifikate rezulton se i ndjeri ka qenë me status të gjendjes civile beqar në kohën kur ai ka lidhur martesën më dt. 15.11.1954.





A2022010480010852552

Në bazë të Çertifikatave Familjare gjendja familjare për vitet 1950-1974, 1980, 1991, dhe 1998 të lëshuara nga Zyrat e Gjendjes Civile Arkiva Elbasan dhe Zyra e Gjendjes Civile Gostimë vërtetohet se nga martesat mes tyre kanë patur 9 (nëntë) fëmijë.

Nga shqyrtimi i të gjitha çertifikatave rezultojnë se pas vdekjes së trashëgimlënësit jetojnë 8 fëmijë dhe bashkëshortja e trashëgimlënësit.

Sipas Çertifikatës së Vdekjes me nr. 016618672 dt. 09.02.2022 për Shemsie Halit Petalli që është dhe e bija e trashëgimlënësit rezulton se ajo ka ndërruar jetë më parë se i ati i saj më dt. 27.05.1964 me gjendje civile beqare (minorene) ndaj dhe nuk ka zotësi për të trashëguar.

Sipas Çertifikatës Personale për z. Sotir Halit Petalli të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Gostimë më dt. 02.02.2022 thuhet se është bërë ndryshimi i emrit sipas vendimit të Këshillit të Komunës Gostimë nga Mustafa Petalli në Sotir Petalli.

Sipas Vërtetimit të lëshuar nga Bashkia Korçë dt. 14.02.2022 thuhet se: Me vendim të Këshillit Bashkiak të qytetit Korçë nr. 103 dt. 01.11.1999 shtetësja Anthuela Ago e datëlindjes 28.02.1962 ka bërë ndryshimin e emrit nga Hedije në Anthuela.

Nga shqyrtimi i të gjitha çertifikatave të trungut familjar, si dhe çertifikatave personale rezulton se:

Trashëgimtarë të radhës së parë të të ndjerit **HALIT PETALLI** janë:

- 1- **SOSE ZYFER PETALLI**, bashkëshortja, e datëlindjes 28.10.1938 me numër personal D86028003D, lindur në Hajdaran, Elbasan dhe banuese në Gostimë, Shushicë, Cërrik, Nd. nr. 005, Gjendja Civile e Ve.
- 2- **MUHAMET HALIT PETALLI** i biri, i datëlindjes 12.02.1955, me nr. personal F50212005B lindur në Shushicë, Elbasan dhe banues në Bradashesh, Elbasan, Nd. nr.10, H.1, Gjendja Civile i Martuar.
- 3- **SOTIR HALIT PETALLI** i biri, i datëlindjes 11.02.1957, me nr. personal F70211005V lindur në Shushicë, Elbasan dhe banues në Gostimë, Cërrik, Nd. nr. 18, H.1, Gjendja Civile i Martuar.
- 4- **ANTHUELA HALIT AGO (PETALLI)** e bija, e datëlindjes 28.02.1962, me nr. personal G25228073H lindur në Shushicë, Elbasan dhe banuese në Raj nr. 5, Lagjia 5 Maj, Nd. 722/1, H.1; Ap.7, Elbasan, Gjendja Civile e Ve.
- 5- **BEDRI HALIT PETALLI**, i biri, i datëlindjes 30.03.1965, me nr. personal G50330009M lindur në Shushicë, Elbasan dhe banues në 28 Nëntori, Nd. 9, H.9, Ap.9, Gjendja Civile i Martuar.
- 6- **HALISA HALIT DUSHKU (PETALLI)** e bija, e datëlindjes 01.02.1968, me nr. personal G85201031S lindur në Shushicë, Elbasan dhe banues në Jagodinë, Shirgjan, Elbasan, Gjendja Civile e Martuar.
- 7- **LAVDIJE HALIT JANÇA (PETALLI)** e bija, e datëlindjes 16.03.1970, me nr. personal H0531603W lindur në Shushicë, Elbasan dhe banuese Lagjia "Qemal Stafa" "Ruga Çerçiz Topulli; Nd. 10; H.15; Ap.16; Elbasan, Gjendja Civile e Martuar.
- 8- **ILIR HALIT PETALLI**, i biri, i datëlindjes 31.01.1974, me nr. personal H40131010P lindur në Gostimë, Elbasan dhe banues në Gostimë, Shushicë, Nd. nr. 5, H.1, Gjendja Civile i Martuar.
- 9- **HATINA HALIT HOXHA (PETALLI)** e bija, e datëlindjes 16.07.1978, me nr. personal H85716154G lindur në Gostimë, Elbasan dhe banues në Aleks Buda, Nd. 15, H.1, Ap.7, Elbasan, Gjendja Civile e Martuar të cilët bazuar në nenet 360 e 361 të Kodit Civil në fuqi, thirren në trashëgim si të vetmit trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë, duke trashëguar sejcili nga 1/9 pjesë të pasurisë trashëgimore të lënë nga trashëgimlënësi Halit Jakup Petalli.

Nuk rezulton që ndonjëri nga trashëgimtarët e mësipërm të ketë hequr dorë nga trashëgimia apo të jetë bërë i padenjë për të trashëguar.

Kërkesa bëhet për efekt të kalimit të të drejtave pasurore të trashëgimlënësit të përmendur më sipër, në favor dhe në emër të trashëgimtarëve të tij.

Për sa më sipër kërkesa e paraqitur nga kërkuesi është e drejtë, e bazuar në prova e në ligj dhe si e tillë duhet të pranohet.





A2022010480010852552

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet: 316, 317, 318, 320, 348, 360 e vijues të Kodit Civil, si dhe neni 61, pika 1, shkronja d, j; nenet 97, 111, 112, 113 e vijues të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për noterinë";

V E N D O S A:

Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin **HALIT JAKUP PETALLI**, duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë:

1- SOSE	ZYFER	PETALLI	- bashkëshortja	1/9 (aktualish e vdekur)
2- MUHAMET	HALIT	PETALLI	- i biri	1/9
3- SOTIR	HALIT	PETALLI	- i biri	1/9
4- ANTHUELA	HALIT	AGO (PETALLI)	- e bija	1/9
5- BEDRI	HALIT	PETALLI	- i biri	1/9
6- HALISA	HALIT	DUSHKU (PETALLI)	- e bija	1/9
7- LAVDIJE	HALIT	JANÇA (PETALLI)	- e bija	1/9
8- ILIR	HALIT	PETALLI	- i biri	1/9
9- HATINA	HALIT	HOXHA (PETALLI)	- e bija	1/9

të cilat trashëgojnë sipas pjesëve si më sipër pjesë sejcili të pasurisë së lënë trashëgim nga trashëgimlënësi **HALIT PETALLI**

Kërkuesja mori dijëni dhe iu sqarua nga Noteri detyrimi ligjor për depozitimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, brenda afatit ligjor prej 30 (tridhjetë ditë kalendarike), nga data e lëshimit të saj. Në rast të kundërt, për çdo ditë vonesë, aplikohen penalitetet përkatëse sipas dispozitave ligjore në fuqi, referuar nenit 25, pika 2 e ligjit 111/2018 "Për Kadastrën".

Dëshmia e trashëgimisë, pavarësisht rrethit të trashëgimtarëve në çastin e regjistrimit pranë institucionit përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, nuk mund të çënojë pjesën e bashkëshortit të prezumuar bashkëpronar për pasuritë e përfituara përgjatë martesës. Nëse trashëgimlënësja ka pasuri bashkëshortore të përfituara përgjatë martesës, por të regjistruara në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, vetëm në emrin e saj, regjistrimi i pjesës takuese të trashëgimisë ligjore do të bëhet duke zbritur 1/2 pjesë të prezumuar të bashkëshortit pasjetues, në referim me nenin 76 të Kodit Civil, nenit 112, pika e ligjit 110/2018 "Për Noterinë".

Shpenzimet Noteriale i ngarkohen kërkuesit.

Kjo dëshmi trashëgimie përbëhet nga 3 (tre) faqe dhe lëshohet në kopje origjinalë nga të cilët, njëri depozitohet në arkivin e zyrës noteriale, nga një kopje i dorëzohet kërkuesit për ta paraqitur në institucionet përkatëse (për aq pasuri sa disponon) dhe nga një kopje u jepet trashëgimtarëve ligjorë.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj dëshmie, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Kundër këtij vendimi për lëshim dëshmi trashëgimie ligjore, mund të bëhet ankim në Gjykatën kompetente, sipas rregullave për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Në po këto raporte trashëgimtarët do të marrin përsipër dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo trashëgimi, duke ju bërë e ditur dhe afati kohor për regjistrimin e kësaj dëshmie brenda 30 ditëve nga data e sotme e këtij vendimi.

U lëshua në Elbasan, sot më datë 22.02.2022 (njëzetë e dy Shkurt dymijë e njëzet e dy).

NOTER

FJOREL R. ÇOMO



Fjorel R. Çomo